

**LIGJ**  
**Nr.10 135, datë 11.5.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9128, DATË 29.7.2003 “PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË FINANCIAR TË PILOTËVE FLUTURUES, NË PENSION”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Në fund të nenit 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:  
“Në kategorinë e sipërpërmendur përfshihen dhe pilotët/teknikët e njësisë së transportit mjekësor me helikopter, të cilët kanë fluturuar me helikopterë.”.

**Neni 2**

Në fund të nenit 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:  
“Me pagë referuese, për pilotët/teknikët e njësisë së transportit mjekësor me helikopter, për efekt të këtij ligji, kuptohet paga e grupit, plus pozicionin dhe shtesat për fluturime, të njehsuara me pagën referuese të funksionit organik të pilotit/teknikut të kësaj njësie, në të njëjtën detyrë me përfituesin, në çastin e lindjes së të drejtës për trajtim të veçantë financiar.”.

**Neni 3**

Në fund të nenit 6 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:  
“Kur funksionet organike, në çastin kur piloti/tekniku i njësisë së transportit mjekësor me helikopter ka dalë në pension pleqërie, nuk ekzistojnë më në strukturën e Ministrisë së Shëndetësisë, Ministri i Shëndetësisë bën njehsimin e tyre, për efekt të pagës referuese, me funksionet organike, që ekzistojnë në çastin kur pilotit/teknikut i lind e drejta e përfitimit të këtij trajtimi.”.

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6186, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Bamir Topi**